



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 584 prot.

Datë 15 / 9 2023

URDHËR

Nr. 523, datë 15 / 9 2023

PËR

DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 22, 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të pikës 2, të nenit 11 të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, z. Erzen Tola Sekretar i Përgjithshëm, si vijon:
 - a) të nënshkruajë autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në emër të nëpunësit që do të përfaqësojë ministrinë në të gjitha gjykatat dhe shkallët e gjykimit, duke përfshirë kërkesëpadi, kërkesë, shtim, pakësim, saktësim apo heqje dorë nga objekti i kërkesëpadisë, kundërpadi, ankim dhe recurs kundër vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare, kërkesë për pezullim, kërkesë për përjashtim gjyqtari, si dhe çdo kërkesë tjetër që ka lidhje apo del nga rrethanat e gjykimit të kësaj çështjeje, si edhe t’i nënshkruajë ato. Përfaqësuesi i autorizuar nga z. Erzen Tola, Sekretar i Përgjithshëm, i përcaktuar sipas kësaj pike, ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural përpara gjykatës, konform parashikimeve të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet në aktin e autorizimit;
 - b) delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, për të gjitha procedurat e prokurimeve publike me fonde buxhetore dhe të huaja për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit;
 - c) autorizimet për dërgim me shërbim të punonjësve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, jashtë qendrës së punës, brenda vendit të punës, në largësi mbi 100 km dhe jashtë vendit;

- d) vënie në zbatim të programit institucional të transparencës dhe rishikimin e tij sipas së njëjtës procedurë që është miratuar, në zbatim të legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit;
- e) të nënshkruajë marrëveshje për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, me palë të treta sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi;
- f) të nënshkruajë urdhrat për ngritjen e grupeve të punës me nëpunës të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit apo strukturave vartëse për hartimin e projektakteve ligjore dhe nënligjore që mbulon fusha e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;
- g) të nënshkruajë ankimet administrative drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;
- h) të nënshkruajë komunikimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me institucionet e administratës publike dhe palët e treta, me përjashtim të atyre komunikimeve dhe akteve që ligji ia atribuon ministrit;
- i) të kryejë çdo veprimtari tjetër të ngarkuar me urdhër apo autorizim nga ministri.
2. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit, si edhe me pushimin e ekzistencës së organit delegates ose të deleguar.
3. Urdhrat nr. 643, datë 28.10.2022, nr. 650, datë 1.11.2022, nr. 651, datë 1.11.2022 “Për delegimin e kompetencave”, shfuqizohen.
4. Ngarkohet Z. Erzen Tola, Sekretar i Përgjithshëm dhe të gjithë nëpunësit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI
OGERTA MANASTIRLIU

